



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:255373

Datë: 08.12.2023

Numri i dokumentit: 05038556

C-IV.-14-6211

Paditësi

R S nga f.sh B K.Lipjan, të cilin me autorizim e përfaqëson Sh S avokat nga Lipjan.

Kundër

E paditura

N.SH “Shpezëtaria”, të cilën e përfaqëson **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rruga “Dritan Hoxha”, Lakrishte, nr.55 , Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me dt.08 dhjetor 2023, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

1. Procedura në këtë çështje juridike NDËRPRITET për shkak të vdekjes së ankuesit R S.

2. Procedura do të vazhdohet kur trashëgimtarët e të ndjerit kërkojnë vazhdimin e procedurës.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.25 shtator 2014, i autorizuari i ankuesit parashtroi ankesë për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën prej vitit 2007 deri në vitin 2012, në shumë prej 8,424.00€ nga kundër N.SH “Shpezëtaria”. Në ankesë kërkohet që gjykata të merr vendim me të cilin do të

prishet vendimi i AL PRN006-0029 dt.20.08.2014 dhe të Detyrohet NSH-ja që ushtruesit të ankesës të ia kompensoj pagat e pa paguara me kamatë ligjore. Së bashku me ankesë kanë bashkëngjitur: Kopjen e vendimit të AL, Librezën e punës.

E paditura e ka paraqitur mbrojtjen e saj me dt.29 shtator 2023.

Me dt.05 tetor 2023, gjykata i dërgoj vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore për padi. I autorizuari i ankuesit përmes parashtresës së dt.26 tetor 2023, e ka njoftuar gjykatën se ankuesi ka ndërruar jetë.

Arsyetimi ligjor

Procedura në këtë çështje juridike ndërpritet për shkak të vdekjes së ankuesit.

Sipas nenit 76 par.3 të Ligjit Nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parasheh: *“Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.”*

Kurse sipas dispozitës së nenit 277 pika (a) të LPK-së: *Procesi gjyqësor ndërpritet: a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale, e nuk ka të caktuar përfaqësues me prokurë në gjykim.*

Në vazhdim dispozita e nenit 280 par. 1 të LPK-së parasheh: *“Procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277 paragrafi 1 pika a)–d) të këtij ligji do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare.”*

Andaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 277 pika (a) dhe nenit 280 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r e
Hajrie Shala